



United Nations
Nations Unies



International
Criminal Tribunal
for the former
Yugoslavia

Tribunal Pénal
International pour
l'ex-Yougoslavie

**ATTESTATION BY THE PRESIDING OFFICER PURSUANT TO RULE
92 BIS(B)**

I, RAM DORAISWAMY, Presiding Officer appointed by the Registrar of the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia on 23-04-2007 pursuant to Rule 92 bis of the Rules of Procedure and Evidence, with the assistance of a certified interpreter, certify;

that on 23/04/2007 in JABLANICA E MADHE, PEJE MUNICIPALITY

the following person appeared:

Witness's First and Last name(s): MAHIR DENAJ

Date and Place of Birth: 01/05/1976 in JABLANICË E MADHE

Identity-, or Passport No.: (UNMIK ID CARD) NO. 1006832713

Habitual Residence: JABLANICË E MADHE, PEJE MUNICIPALITY,

- that in the attached statement dated 23/04/2007 + 16/04/2007 and certified by the undersigned on 23/04/2007 the said witness is identified as the author;
- that the above-mentioned witness was provided with a version of the said statement in a language that he (she) understands;
- that the above-mentioned witness was informed, in a language that he (she) understands, by the Presiding Officer that if the contents of the written statement are not true to the best of his (her) knowledge and belief then he or she may be subject to proceedings for giving false testimony;
- that the above-mentioned witness was provided with a text of Rule 91 of the Rule of Procedure and Evidence, in a language he (she) understands;



Rule 92 bis


- that above-mentioned witness declared that the content of his (her) written statement are true and correct to the best of his (her) knowledge and belief;
- that no pressure was brought to bear on the witness and that he (she) voluntarily signed the attached declaration dated 23-04-2007;
- that the following persons were present during the said declaration:
 - MR. SHAZADA SULTAN - INVESTIGATOR
 - MR. GLIR ZIU - INTERPRETER
 - MR. RAM DORAISWAMY - PRESIDING OFFICER
 - MR. MAHUR DEVAJ - WITNESS

Additional remarks:

- TOTAL NO. OF PAGES CERTIFIED: 12
- 2 STATEMENTS CERTIFIED, INCLUDING AN ADDENDUM DATED 23/04/2007.

Done this 23rd day of APRIL 2007
 At JABLANIČE NADJE, PEJE MUNICIPALITY.

Signature of the Presiding Officer


Presiding
Officer

Rule 92bis

DEKLARATA E KONSOLIDUAR E DËSHMITARIT MAHIR DEMAJ

TRIBUNALI NDËRKOMBËTAR PËR NDJEKJEN PENALE TË PERSONAVE
PËRGJEGJËS PËR SHKELJE TË RËNDA TË SË DREJTËS HUMANITARE
NDËRKOMBËTARE TË KRYERA NË TERRITORIN E ISH-JUGOSLLAVISË PREJ
VITIT 1991

DEKLARATA E DËSHMITARIT**TË DHËNA MBI DËSHMITARIN:**

Mbiemri: DEMAJ

Emri: Mahir

Pseudonimi: ...

Emri i babait: Selim **Emri i nënës:** Kune

Datëlindja: 01.05.1976 **Gjinia:** mashkull

Vendlindja: Jabllanicë e Madhe, komuna e Pejës

Origjina etnike: shqiptar i Kosovës **Përkatësia fetare:** musliman

Profesioni i tashëm: bujk **I mëparshëm:**

Gjuhë të folura: shqip

Gjuhë të shkruara: shqip

Data e intervistës: 16/04/2007 dhe 18/04/2007

Vendi i Intervistës: Jabllanica e Madhe, Kosove

Intervistues: Barney KELLY

Përkthyes: Gazmend TROKA


Gjuhë të përdorura gjatë intervistës: shqip dhe anglisht


Emrat e të gjithë personave të pranishëm gjatë intervistës: Z. Mahir DEMAJ, Gazmend TROKA, Znj. Antoinette ISSA, Znj Romana SCHWEIGER, Barney KELLY.

Nënshkruar: /nënshkrimi/



Të tjerë të pranishëm: /nënshkrimet/

1 


Presiding
Officer

Rule 92 bis

11

U0161094

DEKLARATE E KONSOLIDUAR E DËSHMITARIT MAHIR DEMAJ**DEKLARATA E KONSOLIDUAR E DËSHMITARIT:**

1. Më është kërkuar të japë deklaratë për Tribunalin Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë (TPNJ). Askush nuk më ka kërcënuar ose detyruar e as nuk më janë dhënë premtime apo joshje në lidhje me këtë.
2. Jam dakort të japë deklaratë me shkrim dhe ta nënshkruaj. Më kanë treguar se deklaratata ime mund të përdoret si provë në procesin e TPNJ-së.
3. Kam lindur në fshatin Jabllanicë e Madhe, komuna e Pejës, ku kam jetuar gjatë gjithë jetës. Pas përfundimit të shkollës së mesme, shkova në shkollën e lartë në Pejë, ku studjova ekonominë. Për shkak të luftës, nuk isha në gjendje të diplomohem, kështu që provimet e fundit i dhashë në qershor 1998. Pas kësaj, vendosa t'i bashkohem UÇK-së.
4. Përafërsisht në kohën kur aeroplanët serbë sulmuan fshatin Loxhë, vendosa t'i bashkohem UÇK-së por une nuk e dija se ku ndodhej Shtabi I UCK-se. Më kujtohet se e pata takuar Pal KRASNIQIN në Pejë, të cilit i tregova për vendimin tim që t'i bashkohem UÇK-së. Meqë edhe ai e kishte atë qëllim dhe e dinte rrugën vendosëm të shkonim bashkë dhe t'i bashkohemi UÇK-së. Kur e takova në Pejë, ai më tha se kishte qenë në zonën e UÇK-së dy herë. Nuk e dija saktësisht se ku po shkonim.
5. Të dy shkuam me autobus në Tërstenik, i cili është diku midis Pejës dhe Klinës. Po shkonim drejt një fshati të quajtur Krushevë që ndodhet afër Klinës sepse Pali donte ta kalonte natën në shtëpinë e nënës. Rrugës na ndalën një grup civilësh të armatosur serbë të fshatit Krushevë. Pasi na ndalën, ata thirrën policinë e uniformuar, të cilët arritën pas pak. Ata filluan të na rrahin dhe shqelmojnë me të arritur. Më kujtohet se Pali i kerkuan të heqi xhaketen. Më vonë, na dërguan në stacionin policor në Klinë, ku rrahja vazhdoi. Pali dhe mua na futën në një dhomë dhe filluan të na marrin në pyetje. Meqë unë nuk kuptoj serbisht, nuk i kuptoja pyetjet e tyre. Arrita të kuptoj vetëm se donin të dinin se për ku ishim nisur. Gjatë marrjes në pyetje, na rrahën keqas me grushta dhe shqelma. Mua gjithashtu më rrahën me shufër metalike dhe pas kësaj

Nënshkruar: /nënshkrimi/



Të tjerë të pranishëm: /nënshkrimet/

2

Barney Kell ^{26/04/07}
 Mary Kell ^{26/04/07}
 ar

Presiding
Officer

Rule 92 bis

10

DEKLARATE E KONSOLIDUAR E DESHMITARIT MAHIR DEMAJ


humba vetëdijen për një farë kohe. Kur më erdhi vetëdija, e dëgjova Palin të më thoshte të ngritesha se përndryshe do të më vrisnin nëse nuk do t'iu bindesha urdhërave të tyre. Kur u ngrita, e vërejta gjithashtu se edhe një person civil u fut në dhomën në të cilën na mbanin mua dhe Palin. Ai ishte tallac dhe me trup të shëndetshëm. Ai mu drejtua në shqip dhe më pyeste pse më kishin rrahur aq keq. Provova t'i spjegoj se nuk flas serbisht dhe prandaj më kishin rrahur. Ai gjithashtu më pyeti se prej nga jam dhe se ku isha nisur. I tregova se jam nga Jabllanica e Madhe, komuna e Pejës. Gjithashtu ia tregova emrin tim dhe emrin e babait. Kështu ai mund t'i konfirmonte të dhënat me policinë në Pejë. Gjatë kohës sa ishim në polici, unë isha gjithë kohën me Palin, përveç disa minutave.

6. Ishte diku nga mesnata kur na liruan nga stacioni i policisë. Më kujtohet se e pyeta Palin se ku po shkonim. Pali ishte i detyruar të më bartte sepse nuk isha në gjendje të ecja vet. Nuk e di se ku shkonim. Më kujtohet se përfundua në një shtëpi, ku na kishte sjellë Pali. Gjatë kësaj kohë, policia na kërkonte. Ne u fshehëm, por ata përsëri na gjetën. Më goditën përsëri me revole në kokë. Pali filloi t'i lusë të mëshiroheshin dhe të mos më vritnin. Na futën në një makinë policie dhe na dërguan në drejtim të Pejës. Por, për arsye të panjohura, na kthyen përsëri në Klinë, ku na liruan më vonë. Pas liritimit tonë, u nisëm për në kishë, e cila është në drejtim të Zllakuqanit.
7. Ne hyme në kishë dhe pritëm atje. Mund të degjonim policet që shtinin me arme here pas here. Rreth orës 04 :00 të mëngjesit Pali me tha se një polic serb i tha se duhet të paraqiteshin tek Komandanti i Stacionit të Policisë në orën 08 :00 të mëngjesit.
8. Nga kisha shkua në postë, ku Pali i telefonoi babait dhe i tregoi për ato që na kishin ndodhur. Meqë nuk e kishim ndër mend të paraqiteshim në polici, siç na kishin urdhëruar, vazhduam rrugën në drejtim të Novosellës dhe më tutje për në Grabanicë. Në Grabanicë, vazhduam rrugën buzë kanalit të betonit, të cilin na duhej ta kalonim. Pasi e kaluam kanalin, e takuam një grup të shqiptarëve të Kosovës, të cilët dukeshin të ishin roje të UÇK-së së fshatit. Ata ishin të armatosur, por në rroba civile. Njëri nga ata na u bashkua dhe na pyeti nëse donim të vazhdonim për në zonën e UÇK-së. i

Nënshkruar: /nënshkrimi/



Të tjerë të pranishëm: /nënshkrimet/



3



Rule 92bis

9

DEKLARATË E KONSOLIDUAR E DESEMITARIT MAHIR DEMAJ

përgjigjëm « po » dhe ai na tregoi rrugën për në fshatin Jabllanicë që është në komunën e Gjakovës.

9. Rrugës për në Jabllanicë pashë shumë pjesëtarë të UÇK-së në rrugë. Kisha përshtypjen se Pal KRASNIQIN e njihnin mirë në atë zonë dhe ai njëhte shumë ushtarë sepse ushtarët rrugës e përshëndesnin teksa po mbërrinin në Jabllanicë. Po ashtu kisha përshtypjen se po stërvisnin rekrutë të rinj në rrugën ku kisha parë ushtarët e UÇK-së sepse pashë disa djem të rinj me rroba civilësh që ecnin me ushtarë të UÇK-së me uniformë.
10. Kur arritëm në Jabllanicë, Pal KRASNIQIN dhe mua na dërguan në një spital të improvizuar që ishte në një shtëpi private dykatëshe. Mua më çuan në një dhomë në katin e dytë, ku kishte ushtarë të tjerë të plagosur që po kuroheshin. Iu tregova doktorit dhe të tjerëve në spital se si dhe përse kisha përfunduar aty. Iu treguam dhe për rrahjen. Të pranishëm ishin dhe 2 apo 3 ushtarë të UÇK-së me uniformë dhe ata na dëgjonin teksa i shpjegoja doktorit se si isha lënduar. Ushtarët e UÇK-së nuk më bënë pyetje. Në paragrafin 9 të deklaratës sime të mëparshme të datës 12 dhjetor 2005 thuhet se më çuan në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë, por kjo nuk është e saktë dhe na çuan veç në spital.
11. Një mjek, emrin e të cilit nuk e di, më ofroi mjekim. Ai ishte afër 40 vjeç dhe ishte me trup të plotë. Me bëri gjashtë injeksione dhe me lidhi me fasho brinjët e thyera. Pas injeksioneve hëngrëm diçka që të gjithë në një shtëpi pranë spitalit. Në shtëpinë ku hëngra kishte disa njerëz me rroba civile dhe të tjerë me uniforma që hynin e dilnin nga shtëpia. Pasi hëngra fjeta në një krevat në të njëjtin vend ku kisha ngrënë. Pastaj u ktheva në spital.
12. Kur isha në spital pashe te pakten 10 persona që po mernin ndihme mjeksore. Me kujtohet gjithashtu një ushtar i UÇK i plagosur me plumb. Nuk më kujtohen emrat e atyre që i kam parë në spital apo në shtab në Jabllanicë, meqë nuk e njihja atë zonë. Qëndrova vetëm një natë në spital dhe u largova në mëngjes në kundërshtim me këshillat e mjekut.
13. Të nesërmen, disa të afërm të mi erdhën në Jabllanicë t'i bashkoheshin një grupi të madh që shkonte në Shqipëri të marrë armë. Të afërmit më thanë që të shkoja në Junik


Nënshkruar: /nënshkrimi/

Demaj

Të tjerë të pranishëm: /nënshkrimet/

Barney Kelly
Monica P...
...

4



2

DEKLARATE E KONSOLIDUAR E DESHMITARIT MAHIR DEMAJ

me grupin tim. Vendosa t'i bashkohem atij grupi dhe të njëjtën ditë u nisëm për në Junik. Para se të largohesha pashë grupe të paarmatosura që i ndamin për t'i çuar në Shqipëri për të marrë armë. Pasi të kishin marrë armë ata mund të ktheheshin në fshatrat e tyre për t'i mbrojtur nga serbët. Nuk i njihja njerëzit që po organizonin këto grupe.

14. Para se të nisesha për Junik, fola me Palin dhe e luta të vijë me mua. Ai më tha se donte të rrinte me shokët e tij në Jabllanicë dhe më vonë mund të shkonte në shtëpi. Pal KRASNIQI mbeti në Jabllanicë. Kjo ishte hera e fundit që e pashë Pal KRASNIQIN. E lashë përpara spitalit në rrugën e Jabllanicës. Ishte në rroba civile me blu xhinse. Ishte një gjatësi me mua, 175 cm, dhe me flokë ngjyrë kafe.
15. Pas luftës, fola një herë me babain e Pal Krasniqit dhe i tregova se çfarë na kishte ndodhur rrugës për në Jabllanicë. Nuk kam informata tjera për fatin e Palit.
16. Në Junik qëndrova 4-5 ditë dhe, pasi nuk qamë në gjendje të kalojmë kufirin për në Shqipëri, unë shkova në shtëpi. Kurrë nuk jam kthyer më në Jabllanicë, meqë ajo u sulmua nga forcat serbe pak pasi u nisa për Junik. Unë nuk u regjistrova si ushtar i UÇK-së sepse mendoj që për të bërë këtë duhej të kaloja kufirin për në Shqipëri me qëllim që të merrje një armë dhe një uniformë. Vetëm pasi të kishe një armë dhe një uniformë mund të bëje betimin e UÇK. Por nuk jam krejtësisht i sigurtë se çfarë duhet të bëje për tu regjistruar si anëtar i UÇK-së. Sidoqoftë arsyeja kryesore që kisha unë për të kaluar kufirin e për të shkuar në Shqipëri ishte në fakt që të merrja trajtim më të mirë mjekësor sepse isha lënduar seriozisht nga policia serbe në Klinë.


VËRTETIM I DESHMITARIT

Nënshkruar: /nënshkrimi/



Të tjerë të pranishëm: /nënshkrimet/

5


Presiding
Officer

Rule 92 bis

7

DEKLARATE E KONSOLIDUAR E DESHMITARIT MAHIR DEMAJ

Kjo deklaratë me 8 faqe më është lexuar në gjuhën shqipe dhe është e saktë me sa une di dhe mbaj mend. E kam dhënë këtë deklaratë vullnetarisht dhe jam i vetëdijshëm se mund të përdoret në Tribunalin Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e Ish-Jugosllavisë Prej Vitit 1991. Gjithashtu, e kuptoj se mund të ftohem të dëshmoj publikisht në TPNJ.

Nënshkrimi: Demaj

Data: _____

Nënshkruar: /nënshkrimi/

Demaj

Të tjerë të pranishëm: /nënshkrimet/

6

Barney Kelly ²⁶
Norman Phayer
Arthur



6

DEKLARATE E KONSOLIDUAR E DESHMITARIT MAHIR DEMAJ**VËRTETIM I PËRKTHYESIT**

Unë Gazmend Troka, përkthyes, vërtetoj se:

1. Jam i kualifikuar dhe i miratuar nga Sekretaria e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë Prej Vitit 1991, për të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.
2. Më ka informuar **Mahir DEMAJ** se ai e flet dhe e kupton gjuhën shqipe.
3. Kam përkthyer me gojë deklaratën e mësipërme nga gjuha angleze në gjuhën shqipe në praninë e **Mahir DEMAJ**, i cili dukej se e ka dëgjuar dhe kuptuar përkthimin tim të kësaj deklarate.
4. **Mahir DEMAJ** ka vërtetuar se faktet dhe çështjet e paraqitura në këtë deklaratë, të përkthyer prej meje, janë të vërteta, me sa di dhe sa i kujtohet, dhe rrjedhimisht ka nënshkruar në vendet përkatëse.

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Nënshkruar: /nënshkrimi/

Dag

Të tjerë të pranishëm: /nënshkrimet/

Barney Kelly
Montano
Antun



Shtojce ne Deshmine e Mahir Demaj

**TRIBUNALI PENAL NDERKOMBETAR PER NDJEKJEN PENALE TE PERSONAVE
PERGJEGJES PER SHKELJE TE RENDA TE LIGJIT NDERKOMBETAR TE KRYERA
NE TERRITORIN E ISH JUGOSLLAVISE QE PREJ1991**

**Shtojce ne
DESHMINE E DESHMITARIT**

INFORMACION PER DESHMITARIN:

Mbiermi: **DEMAJ**

Emri: **Mahir** Emri I mesem:

Atesia: **Selim**

Data e Lindjes: **01/05/1976** Gjinia: **Mashkull**

Vendi I Lindjes: **Jablanica e Madhe, Komuna e Pejës.**

Origjina Etnike: **Shqiptar I Kosoves**

Besimi Fetar: **Musliman**

Punesimi I tanishem: **Bujk**

Gjuhet qe flet: **Shqip**

Gjuhet qe shkruan: **shqip**

Data e Shtojces: **23/04/2007**

Vendi I Intervistes: **Ne shtepine e deshmitarit ne Jabllanice te Madhe**

Intervistuesi: **Hetuesi I TPNJ, Shahzada Sultan**

Perkthyesi: **Ilir Ziu**

Gjuhet e perdorura ne Interviste: **Anglisht dhe Shqip**

Emrat e gjithe personave te pranishem gjate intervistes: **te siperpermendurit: Shahzada Sultan, Mahir Demaj, Ilir Ziu**

Nenshkrimi:



Te tjere te pranishem:



Presiding
Officer



Rule 92 bis

4


Shtojce ne Deshmine e Mahir Demaj

1. Hetuesi I Zyres se Prokurorise Shahzada Sultan me ka dhene mua deshmine time te konsoliduar te marre ne dete 16/04/2007 dhe 19/04/2007 nga hetuesi i Zyres se Prokurorit Barney Kelly. E lexova versionin shqip te deshmise time dhe e nenshkrova ate. Versioni anglisht gjithashtu me eshte lexuar dhe une e nenshkrova ate. Megjithate do te doja ti bashkengjisja nje Shtojce te dy versioneve qe permban disa rregullime qe do te doja, ti beja tani, keshtu qe permbajtja e deshmive te mija jane komplet te sakta. Per me teper versionin shqip I deshmise time mund te konsiderohet si autoritativ meqe ndryshimet e mija bazohen ne kete version, te cilin e kam lexuar personalisht. Ndryshimet e meposhteme do te doja tia beja kesaj deshmije te konsoliduar:
2. Paragrafi Nr. 4: Nuk me kujtohet koha ose dita ose data kur une e vendosa per tju bashkuar UCK-se. Ishte 1998. Pal Krasniqi me tha se e dinte rruget sepse ai kishte qene ne zonen e UCK-se ose para dy javesh ose kishte qendruar atje per dy jave, nuk jam shume I sigurte se cfare me tha.
3. Paragrafi Nr. 7: ky paragraf krijon pershtypjen se nje polic serb i dha urdher Palitne oren 0400 qe ne duhet te paraqiteshim tek komandanti I policies ne oren 0800. Kjo pershtypje eshte e pasakte. Faktikisht Pali ma dha mua kete informacion ne oren 0400; Une nuk e di se kur i dha urdher polici atij per kete.
4. Paragrafi Nr. 8: Ne Grabanice, ne nuk kaluam ndonje kanal betoni; ne kaluam vetem nje vije uji, qe ishte dega e ndonje lumi. Faktikisht, nuk pashe ndonje kanal betoni fare. Nje nga personat e armatosur qe na tregoi rruget per ne Jabllanica te Gjakoves faktikisht na shoqeroi ne per ne fshat. Ai nuk tha se ishte anetar I UCK-se, por thjesht keshtu mu krijua pershtypja.
5. Paragrafi Nr. 9: Rruges per ne Jabllanice, njerezit qe e pershendesnin Palin ishin fshatare dhe jo ushtare te UCK-se. Dua qe ta fshij komplet fjaline e dyte te paragrafit: Nuk pashe ndonje rekrut, apo ndonje njeri tjetër me uniforme te UCK-se ne rruge. Uniformat e UCKse I pashe vetem ne spitalin e UCKse, gje te cilen e kam permendur ne paragrafin 10. Permendja e UCKse ne paragrafin 9 eshte e pasakte; ndoshta une nuk kam qene ne gjendje ta shpjeguj sakte ose intervistuesit e kuptuan gabim.
6. Paragrafi Nr. 12: Fjala shtab mund te hiqet nga versionin Shqip, per ta bere ate te njejte me versionin Anglisht. Nuk e permenda fjalen shtab aty.
7. Paragrafi Nr. 13: Pershtypja ose fakti se dikush po I ndante dhe organizonte grupet e njerezve qe shkonin ne Shqiperi per te marre arme eshte e pasakte. Nuk kam pare njeri qe ti organizonte ata. Mendoj se njerezit po vepronin me deshiren e tyre, sepse te pakten mua nuk me dha njeri urdher per te shkuar aty. Ndoshta kjo ishte sepse mua me pyeten se kush po I organizonte keta njerez dhe une thashe se nuk e di, e cila nuk do me thene se une nuk I njihja ata njerez, por se njerez te tille nuk kishte.
8. Paragrafi Nr. 16: Aresyeja se perse nuk u ktheva ne Jabllanice nuk ishte sepse ajo u sulmua nga forcat serbe, sic thuhet ne deshmine time. Faktikisht, une nuk e di se kur u sulmua fshati. Aresyeja ishte me e thjeshte; Nuk pata mundesi te kaloja kufirin per ne Shqiperi, sepse forcat Serbe e kishin mbyllur kufirin dhe une u ktheva ne fshatin e ashtu si dhe gjithë te tjetert qe nuk e kaluan dot kufirin per ne Shqiperi. Thjesht po shkova pas grupit te madh te njerezve. Fjalja 4 e ketij paragrafi gjithashtu eshte kompozuar pasaktesisht: une nuk e dija se cfare kerkohej prej dikujt per tu bere anetar I UCKse. Une shkova me Palin ne Jabllanice per tu bere anetar I UCK-se, por nuk I kerkova kujt qe te

Nenshkrimi:



Te tjere te pranishem:



Rule 92 bis

Shtojce ne Deshmine e Mahir Demaj

me regjistronte si anetar. Nuk e dija nese duhet ndjekur ndonje procedure per tu bere anetar I UCKse. Ndoshta kjo fjali u kompozua ne kete menyre duke u bazuar ne llojet e pyetjeve qe mu bene gjate intervistes. Nuk I kam thene ndonjehere fjalet qe jane thene ne fjaline numer 4.

VERTETIM I DESHMITARIT

E kam lexuar dhe nenshkuar kete Shtojce ne gjuhen Shqipe e cila eshte e vertete me sa me kujtohet dhe me sa mbaj mend. Kjo shtojce mund te lexohet bashke me deshmine time te konsoliduar te cilen sapo e kam firmosur.

nenshkrimi: _____

Data: 23/04/2007

CERTIFIKIM I PERKTHYESIT

Une, Ilir Ziu, Perkthyes, vertetoj se:

1. Jam I kualifikuar dhe aprovuar nga Zyra e Regjistrimit e Tribunalit Penal Nderkombetar per Ndjekjen Penale te Personave pergjegjes per Shkelje te Rend ate Ligjit Nderkombetar te Kryera ne Territorin e ish Jugosllavise qe nga 1991 per te perkthyer nga gjuha Shqipe ne gjuhen Angleze dhe nga gjuha Angleze ne gjuhen Shqipe.
2. Mahir DEMAJ me ka informuar se ai lexon, flet dhe kupton gjuhen Shqipe.
3. Mahir DEMAJ e ka lexuar kete shtojce ne gjuhen shqipe.
4. Mahir DEMAJ ka vertetuar se faktet dhe ceshtjet qe permban kjo shtojce, jane te verteta me sa di he me sa I kujtohet atij dhe ka nenshkuar ne vendet perkatese.

Nenshkrimi: _____

Data: 23/04/2007



Rule 92 bis

3

Nenshkrimi: _____

Te tjere te pranishem: _____

Demaj

[Signature]

Ilir Ziu



United Nations
Nations Unies



International
Criminal Tribunal
for the Former
Yugoslavia

Tribunal Pénal
International pour
l'ex-Yougoslavie

U016.1103

DEKLARATË NGA PERSONI QË JEP DEKLARATË TË SHKRUAR NË BAZË TË RREGULLIT 92 BIS

I.

Emr-i/at dhe mbiemr-i/at: MAHIR DEGAJ

Data dhe Vendi i Lindjes: 01/05/1976 IN JABLLANICË E MADHE

Nr i dokumentit identifikues ose pasaportës: UNITIK IDCARD NO: 100693273

këtu me këtë konfirmoj, në prani të Zyrtarit Kryesues RAM DRASKOVIC

se përmbajtj-a/et e deklarat-ës/ave së/të shkruar/a që unë bëra më 16/04/2007/18/04/2007 +

dhe e/të cila/t tani i është/janë bashkëngjitur kësaj deklarate, është/janë e/të vërtetë/a dhe 23/04/2007 (ADJUNKT)

e/të saktë/a me sa di dhe me sa besoj.

Më është dhënë gjithashtu një kopje e Rregullit 91 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Tribunalit në një gjuhë që unë e kuptoj dhe kuptoj se mund të ndiqem penalisht për dhënie të dëshmisë së rreme, në qoftë se përmbajtj-a/et e deklarat-ës/ave sime/të mia të shkruar/a nuk është/janë e/të vërtetë/a dhe e/të saktë/a.

Bërë më: 23/04/2007

Në: JABLLANICË E MADHE,
PEJE MUNICIPALITY,
KOSOVO.

[Signature]

Nënshkrimi i dëshmitarit

[Signature]

Nënshkrimi i Zyrtarit Kryesues

Presiding Officer



Rule 92 bis